

## PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE- 2016

*-MBLEDHJA NR. 4-*

### PËR PËRMIRËSIMIN E MEKANIZMAVE TË ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE MIDIS BIZNESIT DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

**\*\*\***

*Në këtë mbledhje u evidentuan problemet kryesore në lidhje me ankimin/apelimin administrativ, duke u fokusuar tek profili i mosmarrëveshjeve më të shpeshta të biznesit me institucionet e administratës publike, si edhe mekanizmat në dispozicion të palëve për zgjidhjen e tyre. KI miratoi në total 13 rekomandime të cilat u ndanë në 3 drejtime kryesore si më poshtë:*

**a) Akses efektiv për ankimin administrativ**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

1. Lehtësim i aksesit për bizneset në ushtrimin e të drejtës së ankimit administrativ në çështjet fiskale. Pavarësisht se janë kryer përmirësime në këtë aspekt (p.sh: parashikimi në Ligjin 9920 i Garancisë Bankare si alternativë e parapagimit të shumës së detyrimit përpara apelimit).

Garantimi i aksesit real në procedurat e ankimit, duke synuar lehtësimin në ligjet përkatëse të parakushteve për ankimim administrativ, mund të arrihet nëpërmjet njëres prej alternativave të mëposhtme:

- a) Bizneset të parapaguajnë vetëm një pjesë të vogël (10%-15%) të shumës së detyrimit (pa përfshirë gjokat) tatimor apo doganor të rivlerësuar dhe jo 100% sikurse aktualisht; ose
- b) Në vend të parapagimit të një pjese të detyrimit, subjektet të paguajnë vetëm një tarifë administrative të pakthyeshme për depozitimin e ankimit administrativ pranë strukturës apeluese, (p.sh. sipas modelit të zbatuar aktualisht për ankesat e paraqitura nga bizneset në KPP).

Legjislacioni në fushën tatimore dhe doganore duhet të lërë të hapur mundësinë e ankimit administrativ edhe nga subjektet *de facto* të falimentuara, kur këto të fundit të arrijnë t'a provojnë këtë situatë (p.sh. nëpërmjet një raporti të një eksperti të pavarur të fushës).

**b) Efektiviteti i strukturave të apelimit**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

2. Vendimet e DAT, si organi më i lartë administrativ për të vendosur mbi çështjet e Apelimit, duhet të jenë automatikisht të detyrueshme për Drejtoritë Rajonale të Tatimeve (DRT). E drejta e DRT për të ankimuar më tej në gjykatë vendimet e DAT sipas parashikimit të Nenit 109/3 të Ligjit Nr.9920 duhet të shfuqizohet.

3. Të hartohen/përfshihen në akte të brendshme të institucioneve (si AKBN, Inspektoriate, Tatime, Dogana, etj) procedura mbi mekanizmat e konsultimit paraprak dhe konstruktiv me biznesin për trajtimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre (në bazë dhe për zbatim të Ligjit 146/2014).
4. Unifikimi i afateve të ushtrimit të së drejtës së ankimit administrativ është i domosdoshëm. Rekomandohet që afati i ushtrimit të ankimit administrativ të jetë brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni mbi aktin administrativ. Me hyrjen në fuqi në Kodit të Ri të Procedurave Administrative në Qershor 2016, kërkohet përgatitja, rishikimi, publikimi në kohë i procedurave të veçanta administrative për të qenë në përputhshmëri me Kodin e Ri si edhe ndërgjegjësimi i vetë institucioneve. Monitorim i procesit nga Këshilli i Ministrave.
5. Krijimi i një sporteli unik për informim dhe ndërgjegjësim të biznesit për të qenë në pajtueshmëri me kerkesat e legjislacionit (eficenca e strukturave që i shërbejnë biznesit në Tatime/Dogana/QKB)

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

6. Të rritet efektivisht pavarësia e DAT dhe ndarja e funksioneve të saj nga struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Krijimi i një organi kolegjal apelimi në vend të DAT me ligj të veçantë, në trajtën e një “*quasi gjykatë*” në kuadër edhe të planeve për bashkimin e administratës tatimore dhe administratës doganore për të shqyrtuar ankimet administrative (duke filluar nga një shumë e caktuar).
7. Sugjerohet që të ketë një unifikim dhe centralizim të apelimit të Inspektoriateve në Inspektoriatin Qëndror për të rritur profesionalizmin, pavarësinë dhe besimin e ankimit në Inspektoriatet Shtetërore. Për këtë rekomandohet:

Amendimi i Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” në mënyrë që të përcaktohen kompetencat, struktura dhe procedura që do të kryet në Inspektoriatin Qëndror në lidhje me apelimin e vendimit përfundimtar nga ana e subjekteve të inspektimit.

- të shfuqizohen pika 2 dhe pika 3 e nenit 51, në mënyrë që kjo pjesë e procedurës (ankimimi) të centralizohet dhe të kryhet nga një organ i specializuar i sistemit të inspektimit siç është Inspektorati Qëndror.
  - të ndryshohet edhe pika 4, e nenit 16, për të lejuar vendimmarrjen e Inspektoratit Qendror në rastet e ankesave nga subjektet e inspektimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit.
  - Ky funksion të shtohet edhe në funksionet e Inspektoratit Qendror në pikën 2 të nenit 16 të ligjit të inspektimit të unifikohet “Organi Epror” me VKM për krijimin e organit epror duke shfuqizuar pikat e VKM-ve të inspektorateve shtetërore të rikrijuara pas hyrjes në fuqi të ligjit të inspektimit, të cilat kanë të bëjnë me “Organin Epror”.
8. Informatizim (e-filing, online statements, shkëmbim informacioni etj.) i sistemeve midis institucioneve të Administratës dhe shkëmbim *online* të informacionit, si p.sh Tatime, Dogana, ZVRPP, Drejtoritë e Transportit etj. - përmirësim të koordinimit institucional (kjo jo vetëm do të shkurtonte kohën e përpunimit administrativ, por do të rriste edhe transparencën),

9. Interpretimi me anë të një udhëzimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave për procedurat që duhet të ndiqen në rastin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga raportet e KLSH. Organet e administratës publike duhet të shqyrtojnë me grupe pune detyrat dhe rekomandimet e lëna nga KLSH, duke shmangur zbatimin *a priori* të tyre, sidomos në rastin kur nga zbatimi i tyre arbitrar, çënohet siguria juridike dhe të drejta të ligjshme të bizneseve. Kjo do të ulte edhe kostot për buxhetin e Shtetit, në rastin kur e drejta e bizneseve do të vendosej në vend nga gjykatat dhe Shteti do të ishte i detyruar të dëmshpërblente bizneset për dëmin e shkaktuar.
10. Qëndrueshmëri e stafit dhe ngritje e vazhdueshme profesionale e strukturave të apelimit në institucione. Programe trajnimi të përbashkëta midis bizneseve dhe administratës do të parandalonin mosmarrëveshjet midis palëve. Njëkohësisht sugjerohet edhe trajnime të vazhdueshme dhe të përbashkëta midis Gjykatave Administrative, Administratës Tatimore dhe Doganore nëpërmjet shkollës së Magjistraturës me ndihmën edhe të shoqatave të biznesit si psh, Shoqata e Shqiptare e Bankave. Kjo do të ndihmonte edhe në unifikimin e praktikave si për administratën ashtu edhe për Gjyqësorin. Të parashikohen në programet vjetore të punës së Shkollës së Magjistraturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave.
11. Unifikimi i praktikave dhe përgatitja e komentareve për rastet e ngjashme sidomos në Tatime, Dogana dhe Inspektoriate, mundësisht në këndvështrim sektorial si ai bankar, agro-industri, burime natyrore, etj. Kjo shikohet si një ndër elementët më të domosdoshëm, të cilët do të reduktonin në një masë të konsiderueshme numrin e ankimeve ndaj vendimeve të administratës tatimore dhe përmirësimin e treguesit të perceptimit të bizneseve lidhur me të. Një rol shumë të rëndësishëm në unifikim duhet të luajë edhe Avokatura e Shtetit, nëpërmjet rolit të saj aktiv me interpretime për çështje ligjore me karakter përgjithësues për të gjithë administratën publike. Për këtë janë të nevojshme edhe ndryshime ligjore në Ligjin Nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

**c) *Transparenca e strukturave të apelimit***

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

12. Vendimet e DAT/Inspektoriateve/DPD duhet të publikohen në mënyrë sistematike. Ky detyrim si dhe zbatimi i afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave administrata duhet tu përgjigjet ankesave të bizneseve duhen të jenë pjesë e programit të audimit të brendshëm. Kontrolli i zbatimit të parimeve të ankimit garanton një administratë të përgjegjshme dhe profesionale ndaj biznesit.

Publikimi i raporteve vjetore të DPT, DPD dhe Inspektoriateve të veçantë si edhe përfshirja në këto raporte vjetore edhe të rezultateve të ankimeve administrative dhe informacion mbi ecurinë e tyre në Gjykatë.

*-MBLEDHJA NR. 5-*

**POLITIKAT INCENTIVUESE PËR NXITJEN E INVESTIMEVE:  
SHQIPËRIA DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR**

*Objekti i analizës në këtë Mbledhje ishte evidentimi i politikave të incentivave për investime në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, të sjellë këndvështrimin e investitorëve mbi këto politika, por edhe shqetësimet konkrete të tyre mbi klimën e të bërit biznes në vend. KI miratoi në total 6 grupe rekomandimesh të cilat u ndanë në 2 drejtime kryesore si më poshtë:*

**\*\*\***

**a) Incentiva konkrete**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

1. Mbështetje për AIDA për të ofruar produkte promovuese për investitorët. AIDA me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe në koordinim me ministrinë e linjës të përgatisë një inventar të gjithë incentivave që ofron legjislacioni shqiptar mbi investimet dhe sektorët për t'u publikuar në faqen e saj të internetit.
  - 1.1 Të konkretizohet kontributi i Ministrive për të vënë në dispozicion të AIDA periodikisht burimet. Konkretisht:
    - Në përgatitjen e një inventari të të gjithë incentivave që ofron legjislacioni shqiptar mbi investimet dhe sektorët për tu publikuar në faqen e saj të internetit.
    - MZHETTS duhet të vërë në dispozicion databazën e integruar të aseteve publike nën administrim të saj, me qëllim promovimin e mundësive për investim nga AIDA.
    - Ministrinë e linjës duhet të vënë në dispozicion të dhëna sektoriale, me qëllim hartimin e broshurave informuese dhe promovuese sektoriale nga AIDA.
    - Ministrinë e linjës duhet të vënë në dispozicion informacion mbi projekte konkrete investimi mbi të cilat secila ministri është iniciatore apo përgjegjëse, me qëllim promovimin e këtyre projekteve tek investitorë të cilët nuk vijnë me plane konkrete investimi.
    - Secila ministri (apo institucione varësie kompetente) duhet t'i mundësojnë AIDA informacion të detajuar mbi të gjitha hapat dhe hallkat administrative (leje/licence/autorizime) të cilat nevojiten për të realizuar një investim sipas sektorit nën kompetencë.
    - Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë si dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit t'i vënë në dispozicion AIDA skemat e qarta të formave mbështetëse që shteti ofron për investitorët (sipas sektorëve të investimit). Skemat aktuale funksionojnë në bazë aplikimi. AIDA duhet të jetë e mirë-informuar mbi procedurat.
  - 1.2 Përgatitja e produkteve promovuese sektoriale dhe studimeve të fizibilitetit nga AIDA me mbështetjen e MZHETTS duke filluar paraprakisht me zona pilot ose sektorë pilot. Një

sektor që paraqet interes të veçantë dhe kërkon angazhim nga shumë institucione për përgatitjen e një produkti promovues të plotë është industria automotive.

- 1.3 Përmirësimi i informacionit të ofruar nga AIDA nëpërmjet faqes së internetit për investitorët. Mundësisht, ofrimi i të dhënave sektoriale dhe një database me listën e vendeve/ambiente konkrete për investime konkrete. Rritja e burimeve në dispozicion të AIDA në funksion edhe të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin prej Ligjit “Për Investime Strategjike”
2. Ofrimi i incentivave të prekshme për investitorët dhe bizneset:
  - 2.1 Të vlerësohet nga Ministria e Financave në diskutim me grupet e interesit heqja e tatimit për pjesën fitimeve që ri-investohet, si një masë nxitëse për investitorët aktualë, vendas dhe të huaj. Në lidhje me këtë, kërkohet një analizë e diskutim më i gjerë lidhur me efektet, mënyrën e zbatimit dhe kapacitetet e administrates dhe bizneseve për monitorimin e destinacionit të ri-investimeve.
  - 2.2 Të vlerësohet nga Ministria e Financave në diskutim me grupet e interesit shtrirja e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore mbi 3 (tre) vjet.
  - 2.3 Të konsiderohet nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë mundësia që për personat e punësuar rishtaz në sektorët *labor intense dhe në zhvillim* si BPO (*kompani që ushtrojnë aktivitetet për shërbimet outsourcing & call centers*) kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për muajin e parë (periudha e trajnimit) të mbulohen nga Shteti dhe jo nga sipërmarrësi.

*Për t’u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

- 2.4 Parashikime ligjore për t’u krijuar mundësinë efektive Bashkive të reja, për të hartuar dhe zhvilluar zonat e tyre ekonomike në varësi të aseteve dhe burimeve që disponojnë.

**b) Rekomandime mbi klimën e investimeve**

*Për t’u përmbushur në afatgjatë*

3. Krijimi i forcës punëtore të kualifikuar dhe të çertifikuar për procese teknologjike specifike.
4. Koordinim ndër-institucional për të ulur barrën administrative të biznesit, fleksibilitet në komunikim me biznesin, transparencë dhe përfshirje paraprake në hartimin e akteve me impakt biznesin.
5. Një rishikim themelor i legjislacionit tatimor me qëllim reduktimin e burokracive dhe stabilizimin përfundimtar të tij.
6. Rekomandohet krijimi i zonave pilot për investime në turizëm me plane zhvillimore ekonomike dhe urbanistike.

-MBLEDHJA NR. 6-

**PËR FORMALIZIMIN NË BUJQËSI:  
MIRËFUNKSIONIMI I SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË TVSH-së  
DHE NXITJA E INVESTIMEVE**

**\*\*\***

*Në këtë Mbledhje, KI diskutoi mbi një analizë të Sekretariatit e cila evidentonte problematikat e formalizimit të bujqësisë në kuadër të iniciativave të Qeverisë për pajisjen me NIPT të fermerit, skemën e kompensimit me 20% të TVSH-së për prodhuesit bujqësorë dhe mbështetjes financiare të sektorit. Fokusi i analizës lidhet kryesisht me rolin dhe ndikimin që kanë luajtur realisht këto masa në formalizimin e aktorëve, strukturimin e tregut, nxitjen për investime dhe sigurinë ushqimore. Rekomandimi kryesor i miratuar nga KI kërkonte:*

***“Ngritjen e një grupi pune të përbërë nga MBZHRAU, MF, MZHETTS dhe DPT për studimin dhe analizën e thelluar të problematikës së formalizimit në një zonë me aktivitet intensiv bujqësor dhe me numër të lartë të fermerëve të regjistruar, duke konsideruar të gjithë zinxhirin e prodhimit në një nënsektor të bujqësisë. Studimi do të fokusohet në: Skemën e kompensimit të TVSH-së; skemat e subvencioneve dhe lidhjen e tyre me këtë skemë e kompensimit të TVSH; faktorët që pengojnë ose mbështesin procesin e formalizimit (p.sh. çështje që lidhen me inputet). Grupi i punës duhet të analizojë efikasitetin, impaktin social dhe ekonomik të procesit të formalizimit”.***

*KI miratoi në total 16 rekomandime nga të cilat 10 u paraqitën nga Sekretariati dhe 6 të tjera të propozuara në mbledhje nga anëtarët e KI të cilat janë strukturuar si më poshtë:*

**a) Rekomandime në lidhje me vendimmarrjen**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

1. Thjeshtimi i skemave të subvencioneve për fermerët duke mundësuar aksesin e fermerëve në këto skema nëpërmjet dorëzimit të auto-faturës.
2. Rritje e fondit dhe numrit të skemave të subvencioneve.
3. Thjeshtimi i procedurave dhe verifikimi online i të dhënave mbi fermerët nga agjencitë qeveritare.

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

4. Regjistrimi i Fermave dhe Fermerëve. Lidhja e këtij Regjistri me NIPT dhe me një sistem efikas të kompensimit të TVSH-së. Te finalizohet sa më parë me mbështetjen e EUROSTAT procesi i nisur mbi saktësimin e statistikave/të dhënave për sektorin e bujqësisë. Të

ravijëzohet vizioni mbi hapat që do të ndiqen nga institucionet në vijim. P.sh: nëse do të ketë lidhje midis NIPT të fermerit dhe tokës së fermerit.

*Për t'u përmbushur në afatgjatë*

5. Kufiri për transaksionet cash mbetet objekt diskutimi. Megjithatë rishikimi i tij rekomandohet pas një periudhe 1-2 vjet, kur të vlerësohet efikasiteti i kufirit për transaksionet *cash*. Verifikim elektronik i statusit të fermerit nga Drejtoritë Rajonale Tatimore. Akt-marrëveshja midis palëve (blerësit të prodhimeve bujqësore dhe fermerit) të mund të printohet në momentin real të kryerjes së transaksionit. Për këtë amendimi i Nenit 8 të Udhëzimit mbi Skemën e kompensimit të TVSH-së për fermerin të merret në konsideratë.

**b) Rekomandime në lidhje me administrimin**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

6. Zbatimi i funksioneve rregullatore dhe monitoruesem koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

7. Formalizimi të lidhet ngushtësisht me gjurmueshmërinë nga produktet finale të shërbimit. Monitorimi i zbatimit të standarteve dhe kartave teknologjike në të gjithë zinxhirin e vlerës.
8. Rol aktiv dhe bashkëpunim i aktorëve përgjegjës për të përshpejtuar procesin e regjistrimit të tokës.

**c) Rekomandime në lidhje me ndërgjegjësimin**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

9. Platformë të veçantë (dritare) për asistencë dhe informacion ndaj sektorit bujqësor (sqarim dhe ndërgjegjësim mbi NIPT). Rritje të shpërndarjes së informacioni dhe ndërgjegjësimin ndërmjet fermerëve.

**d) Rekomandime të tjera të paraqitura nga anëtarët në KI**

10. Për të nxitur investimet në bujqësi dhe blegtori, rimbursimi i TVSH duhet të jetë i zbatueshëm në të gjithë zinxhirin e vlerës, duke përfshirë dhe ciklin e prodhimit (në varësi të nënsektorëve specifikë).
11. Parakushtet që duhet të përmbushen për të përfituar nga fondet e subvencioneve duhet të jetë të paanshme dhe mbi bazën e kriterëve strikte. Të gjithë aplikuesit që plotësojnë kushtet të shpallen fitues dhe duhet të përfitojnë nga subvencionet pavarësisht shumës së këtyre subvencioneve.



12. Qeveria të ulë çmimin e referencës për blerjen e tokës bujqësore nga investitorët. Çmimet e referencës konsiderohen si “abuzive” dhe duke qenë se ato nuk i korrespondojnë vlerës aktuale të tregut të tokës bujqësore.
13. Regjistrimi i Fermave/Fermerëve dhe Karta e Fermerit duhet të konsiderohet si pika fillestare për formalizimin tërësor.
14. Bankat të rrisin prezencën e tyre pranë bizneseve rurale nëpërmjet degëve të tyre duke ofruar shërbime të dedikuara në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
15. MZHETTS të përgatisë dhe të bëjë të aksesueshme për investitorët një inventar të pronave publike. Ky inventar të përdoret nga investitorët dhe bashkitë si informacion mbi të cilin të përcaktojnë vendet e përshtatshme për ndërtimin e pikave të grumbullimit dhe tregjeve të tyre.

## -MBLEDHJA NR. 7-

### **AKSESI NË FINANCË NË AGROBIZNES**

*Mbledhja u zhvillua në Hotel Tirana International dhe u kryesua nga Znj. Milva Ekonomi, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), me pjesëmarrjen e veçantë të Z. Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Zev/Ministrit të Financave Z. Ervin Mete, si edhe shoqatave të biznesit dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në sektorin e bujqësisë.*

*Në krah të Mbledhjeve nuk u miratuan rekomandime konkrete nga KI, por u prezantua një përmbledhje e gjetjeve fillestare të analizës mbi Sektorin e Agropërpunimit, financiar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) si një nga komponentët e projektit të BERZH për Lehtësim të Agrobiznesit Shqiptar. Për më shumë informacion vizitoni: <https://www.investment.com.al/sq/meeting/mbledhja-nr-7-aksesi-ne-financim-ne-agrobiznes/>*



*-MBLEDHJA NR. 8-*

**MBI RIMBURSIMIN E TATIMIT TË VLERËS SË SHTUAR  
(TVSH) 2015-2016**

**\*\*\***

*Sekretariati gjatë trajtimit të problematikave të biznesit gjatë vitit 2015, veçanërisht mbi Kontrollin Tatimor dhe Informalitetin, ka evidentuar nevojën për rimbursimin e shpejtë të TVSH-së, pa vonesa dhe me një barrë sa më të vogël administrative. Objekti i analizës së paraqitur në këtë mbledhje të KI ishte evidentimi i ecursisë së modelit aktual të rimbursimit të TVSH, duke konsideruar ndryshimet e fundit ligjore dhe eksperiencat e biznesit veçanërisht gjatë 2015-2016. KI miratoi në total 14 rekomandime, 10 prej të cilave të paraqitura nga Sekretariati dhe 4 të tjera të paraqitura nga anëtarët e KI gjatë mbledhjes. Këto rekomandime u strukturuan si më poshtë:*

**a) *Rekomandime lidhur me afatet dhe procedurat për rimbursimin e TVSH. Sistemi i riskut.***

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

1. Respektimi i afateve të parashikuara në kuadrin ligjor për rimbursimin e TVSH-së.  
  
Të vijojë zbatimi i rimbursimit automatik TVSH-së për eksportuesit mbi 70% brenda 30 ditëve, brenda 30 ditëve për eksportuesit 50% – 70% sipas analizës së riskut dhe brenda 60 ditëve për të gjithë tatimpaguesit e tjerë po sipas vlerësimit të analizës së riskut. Realizimi i procedurave brenda afateve ambicioze të parashikuara në kuadrin ligjor mbetet një sfidë për administratën. Pavarësisht faktit që këto afate mund të jenë disi të shkurtra, arritja e tyre duhet të mbështetet në elementët e mëposhtëm:
  - Kritere efektive të analizës së riskut si në Rekomandimin Nr. 2.
  - Trajnime periodike të vazhdueshme për administratën tatimore.
  - Zbatimi edhe për administratën tatimore i detyrimit për të paguar kamatvonesat ndaj bizneseve si rezultat i vonesave të rimbursimit të TVSH sipas parashikimit të Nenit 76 të Ligjit Nr.9920.
  
2. Lehtësimi i barrës procedurale për administratën tatimore dhe bizneset
  1. Zbatimi efektiv i sistemit të riskut që të mundësojë reduktimin në praktikë të numrit të kontrolleve në përgjithësi të administratës tatimore (përfshirë edhe kontrollet për rimbursimin e TVSH-së). Në këtë kuadër të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet DPT dhe DPD edhe për vlerësimin e riskut për rimbursimin e TVSH-së, si pjesë e planeve për ndërmarrjen e analizave të përbashkëta për riskun tatime dhe dogana.

2. Konsiderimi në elementët e riskut të rasteve kur biznesi ka kaluar brenda një periudhe kohore, p.sh. prej 1 viti në kontroll të plotë/thelluar për të shmangur kontrollin e rimbursimit të TVSH-së për periudha tatimore të përfshira në këtë afat. Ky element të njihet edhe në dokumentat e brendshme udhëzues për inspektorët e DPT.
3. Zbatimi korrekt i parimeve për rimbursimin e TVSH-së kur subjekti tatimpagues plotëson kriteret bazë, psh. shumën prej 400,000 Lekë dhe për 3 muaj rresht. Të shmangen praktikat kur bizneseve ju njihen tepërcat kreditore si të kreditueshme, por jo të rimbursueshme mbi bazën e dyshimeve të paarsyeshme dhe të pambështetura në kuadrin ligjor.

*Për t'u përmbushur në afatgjatë*

3. Thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave të rimbursimit të TVSH-së.

Disa prej bizneseve dhe ekspertëve të kontaktuar nga Sekretariati shkojnë përtej në sugjerimin e tyre për thjeshtimin e procesit nëpërmjet rimbursimit automatik të TVSH-së mbi baza mujore për çdo teprice kreditore. Sipas tyre risku i praktikave abuzive në këtë rast është plotësisht i shmangshëm me kryerjen e kontrolleve të thelluara sipas kriterëve të sistemit riskut, kryqëzimit në kohë reale të informacionit midis institucioneve, psh. tatimodogana, tatime-QKB etj. Në këndvështrimin e Sekretariatit një reformë e tillë duhet parë më tepër si objektiv afatgjatë për t'u arritur, sesa si mundësi reale për t'u zbatuar në afat të shkurtër, në kushtet kur ende administrata dhe vetë biznesi janë në faza shumë të hershme të konsolidimit të aktivitetit të tyre për të garantuar përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

**b) Rekomandime për përmirësimin e marrëdhënies administratë-biznes**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

4. Bërja transparente e procedurave të brendshme në trajtimin e rasteve të rimbursimit të TVSH-së.

Sugjerohet përgatitja dhe bërja publike e një dokumenti të brendshëm për administratën tatimore – Rregullore për Rimbursimin e TVSH-së e cila të detajojë parimet dhe kriteret bazë të riskut, hapat, procedurat dhe afatet konkrete që duhet të kenë në konsideratë hallkat e ndryshme brenda administratës tatimore sa i përket kësaj procedure, përfshirë Drejtorinë e Riskut, Drejtorinë e Kontrollit dhe Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së. Dokumenti do të mundësojë përgatitjen profesionale të inspektorëve sidomos në nivel vendor por edhe standardizim të procesit nga niveli qendror në atë lokal. Rekomandohet publikimi i kësaj Rregulloreje si shprehje e standardit të lartë për një administratë transparente, të përgjegjshme dhe në funksion të tatimpaguesve.

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

5. Përmirësimi i informacionit të DPT nëpërmjet një ëbsite interaktiv (përfshirë një help desk ose hub), për biznesin në funksion të edukimit fiskal të tatimpaguesve dhe rritjes së transparencës, por mbi të gjitha një shërbimi më të strukturuar. Në këndvështrimin e Sekretariatit, por edhe në vijim të komenteve të marra nga bizneset, ky informacion është i domosdoshëm por mbetet akoma papërpunuar, dhe jo orientues sipas kërkesave të tyre specifike. Është e nevojshme që informacioni të mbërrijë tek tatimpaguesit në mënyrë më

të strukturuar, qoftë nëpërmjet faqes zyrtare në internet ashtu edhe nëpërmjet sesioneve të trajnimit, ne orare të caktuara online, për kategori të caktuara biznesesh. P.sh mbetet i vështirë orientimi i tatimpaguesit mesatar në faqen e internetit aktuale për të gjetur qoftë edhe ndryshimet më të fundit në legjislacion (viti 2015-2016).

6. Planet buxhetore të mos kushtëzojnë vendimmarrjen e administratës tatimore për vonesat në rimbursimin e TVSH-së kreditueshme. Ky rekomandim është paraqitur gjatë diskutimit të Sekretariatit me ekspertë të fushës në Fokus Group të datës 07.11.2016. Në këtë takim u pranua se respektimi nga administrata tatimore i afateve lidhur me përmbushjen e procedurave të rimbursimit të TVSH, kushtëzohet midis të tjerave edhe nga nevoja e saj për të realizuar planin periodik të të ardhurave tatimore, sipas parashikimit të Ministrisë së Financave. Sipas ekspertëve, zëri i TVSH të rimbursueshme nuk duhet të jetë përgjegjësi e administratës tatimore, por të planifikohet si zë buxhetor më vete. Në këtë mënyrë administrata tatimore do të shmangte “konfliktin e interesit” për realizimin e planit të të ardhurave nga njëra anë dhe respektimin e afateve të parashikuara për rimbursimin e TVSH-së së kreditueshme.

*Për t’u përmbushur në vazhdimësi*

7. Biznesi duhet të ngrejë me tej “kapacitetet e veta” në drejtim të marrjes, informimit në kohë dhe në mënyrë të saktë të çdo lloji ndryshimi që prek mjedisin ku ai operon. Nga analizat e Sekretariatit dhe takimet me të gjithë aktorët, rezulton se është e domosdoshme një angazhim ndoshta me persona të “dedikuar” nga ana e shoqatave të biznesit që të ofrojnë këtë shërbim kundrejt bizneseve, duke ju vendosur në dispozicion informacion të saktë dhe në kohë reale, për të mundësuar edhe një debat e konsultim më të strukturuar në lidhje me ndryshimet që prekin biznesin.
8. Rritja e kapaciteteve të administratës tatimore nëpërmjet trajnime të vazhdueshme dhe specifike për procedura konkrete sikurse edhe rimbursimi i TVSH-së.
9. Integrimi dhe konsolidimi i shërbimeve të agjencive qeveritare në Portalin e-Albania. Ulje e kohës dhe kostove për biznesin në marrjen e vërtëtimeve apo deklaratave rutinë nga DPT, DPD, ZVRPP etj. Promovimi i shërbimeve të këtij Portali në administratat përkatëse.

**c) *Rekomandime mbi klimën e investimeve***

10. Reforma e nisur në 2015, të strukturohet më tej, të forcohen përpjekjet për zbatimin e masave anti-informalitet. Sikurse është rekomanduar nga KI edhe në mbledhjen Nr.3 *“Informaliteti Sfidë e Përbashkët Qeveri–Sipërmarrje” çdo masë në kuadrin e reformës për formalizim duhet të bëhet në partneritet me biznesin e ndershëm.* Zbatimi në vazhdimësi i masave ndaj bizneseve të cilat ushtrojnë aktivitet ekonomik duke mos lëshuar fatura tatimore, duhet të jetë prioritet. Zbatimi i këtyre masave duhet të ketë karakter jo vetëm penalizues, por edhe edukues për të gjithë tatimpaguesit, me objektiv final krijimin e kushteve për konkurrencë të ndershme.

**d) Rekomandime të tjera të paraqitura nga anëtarët në KI**

11. Rritja e burimeve njerëzore të administratës tatimore si domosdoshmëri për t'ju përgjigjur kërkesave të biznesit për një administratë të shpejtë dhe efektive.
12. Nëse tatimpaguesi i është nënshtruar një kontrolli të plotë dhe të thelluar tatimor gjatë vitit të fundit dhe nuk ka qenë subjekt i rivlerësimit tatimor, administrata tatimore t'a konsiderojë këtë fakt duke proceduar me rimbursim automatik dhe pa kontroll.
13. Rritja e edukimit fiskal të tatimpaguesve për të rritur shkallën e pajtueshmërisë me sistemin tatimor.
14. KI nëpërmjet Sekretariatit të kryejë vlerësime në mënyrë periodike si p.sh. Anketa me bizneset lidhur me procedurat, afatet dhe problematikat e rimbursimit të TVSH-së.